



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Sektori i Subjekteve Zgjedhore dhe Dekriminalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION

V E N D I M

PËR

MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE PËR REZULTATIN E VOTIMIT NË
ZONËN ZGJEDHORE QARKU TIRANË, PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE
KANDIDATËT PËR DEPUTETË, NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11 MAJ
2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në zbatim të Dekretit nr. 399, datë 5.12.2024, të Presidentit të Republikës, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë”, më datë 11 maj 2025 u zhvilluan zgjedhjet për Kuvend, si nga zgjedhësit brenda vendit, ashtu edhe nga zgjedhësit jashtë vendit të regjistruar për të votuar.

Zona zgjedhore Qarku Tiranë ka 18 (tetëmbëdhjetë) zona të administrimit zgjedhor (ZAZ), përkatësisht ZAZ nr.27, ZAZ nr.28, ZAZ nr.29, ZAZ nr.30, ZAZ nr.31, ZAZ nr.32, ZAZ nr.33, ZAZ nr.34, ZAZ nr.35, ZAZ nr.36, ZAZ nr.37, ZAZ nr.38, ZAZ nr.39, ZAZ nr.40, ZAZ nr.41, ZAZ nr.42, ZAZ nr.43, ZAZ nr.44.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit e numërimit të votave, Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-të) përkatëse dhe Komisioni për Administrimin e Numërimit dhe Vlerësimit të Votave nga Jashtë (KANVVJ-ja) për këtë qark, plotësuan e miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-ve përkatëse dhe tabelën e rezultateve të këtij qarku për votimin nga jashtë, për zgjedhjet për Kuvend.

Bazuar në nenin 123, pika 1 të Kodit Zgjedhor, është kompetencë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të verifikojë dhe të nxjerrë rezultatet e votimit për Kuvendin për zonën zgjedhore

në bazë të tabelave të rezultateve të nxjerra nga çdo KZAZ dhe nga KANVVJ-ja e qarkut Tiranë.

ZAZ nr.27, ZAZ nr.28, ZAZ nr.29, ZAZ nr.30, ZAZ nr.31, ZAZ nr.32, ZAZ nr.33, ZAZ nr.34, ZAZ nr.35, ZAZ nr.36, ZAZ nr.37, ZAZ nr.38, ZAZ nr.39, ZAZ nr.40, ZAZ nr.41, ZAZ nr.42, ZAZ nr.43, ZAZ nr.44, dhe KANVVJ, kanë depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), tabelat përkatëse të rezultateve për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë të Kuvendit për çdo subjekt zgjedhor, për ZAZ-të përkatës dhe për qarkun Tiranë, vendimin “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore” dhe vendimet “Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për kandidatët për deputetë të partisë/koalicionit”, tabelat origjinale të rezultatit për subjektet zgjedhore për çdo qendër votimi për votimin brenda vendit dhe çdo kutie për votimin me jashtë, tabelat origjinale të rezultateve për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor, për çdo qendër votimi të ZAZ-ve të sipërcituara dhe çdo kutie për votimin me jashtë për këtë qark.

Përpara plotësimit të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zonës zgjedhore të qarkut Tiranë, si për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputetë, u kontrolluan tabelat përmbledhëse të rezultatit përkatësisht të ZAZ nr.27, ZAZ nr.28, ZAZ nr.29, ZAZ nr.30, ZAZ nr.31, ZAZ nr.32, ZAZ nr.33, ZAZ nr.34, ZAZ nr.35, ZAZ nr.36, ZAZ nr.37, ZAZ nr.38, ZAZ nr.39, ZAZ nr.40, ZAZ nr.41, ZAZ nr.42, ZAZ nr.43, ZAZ nr.44, dhe Tabela e Rezultatit të Votimit nga Jashtë për këtë qark, nëse ato përfshijnë të gjitha tabelat e rezultateve të qendrave të votimit për brenda vendit dhe të gjitha kutitë për votimin jashtë të asaj zone dhe rezultoi se:

Tabelat përmbledhëse të rezultateve për subjektet zgjedhore të ZAZ-ve, përfshijnë rezultatin e të gjitha tabelave të rezultateve të kutive të pranura të rregullta për QV-të e tyre. Gjithashtu tabela e rezultateve për votimin jashtë vendit për këtë qark përfshijnë rezultatin e të gjitha procesverbaleve të rezultateve të kutive të pranura të rregullta të këtij qarku.

Në bazë të rezultateve përmbledhëse për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet për çdo subjekt zgjedhor të zonave të sipërcituara, janë hartuar tabelat përmbledhëse përkatëse të rezultateve për zonën zgjedhore Qarku Tiranë.

Bashkëlidhur gjeni projektvendimin, me tabelat përmbledhëse për zonën zgjedhore Qarku Tiranë.

Licela Veliu - Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit

Pavlina Doçaj – Drejtorja e Ligjshmërisë

Daniela Alimemeti – Drejtorja e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Majlinda Çelmeta – Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr.

prot.

Data:

Nr:

Ora: __. __

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E TABELËS PËRMBLEDHËSE PËR REZULTATIN E VOTIMIT NË
ZONËN ZGJEDHORE QARKU TIRANË, PËR SUBJEKTET ZGJEDHORE DHE
KANDIDATËT PËR DEPUTETË, NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 11
MAJ 2025

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, dhe nenit 123, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe kreut VI.2, pika 3, të vendimit nr. 22, datë 20.03.2025, të Komisionit Rregullator, “Për rregullat për administrimin, numërimin dhe vlerësimin e votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumentacionin përkatës, si dhe tabelimin e rezultatit të votimit nga jashtë vendit”, të ndryshuar.

V E N D O S:

1. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për deputetë për 11 subjektet zgjedhore, për zonën zgjedhore Qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025, sipas lidhjes nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data:

Nr.
Ora:



“Për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatit e votimit në zonën zgjedhore Qarku Tiranë për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë, në zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”